

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

SCC-08-0261

██████████  
Llapje Sellë  
I përfaqësuar nga ██████████, avokat nga Fushë Kosova  
kundër

*Paditës*

██████████  
NSH, ██████████, Fushë Kosovë  
E përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**

*E Paditur*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme), Trupi Gjykues i përbërë nga Gjyqtari Kryesues Norbert Koster, Gjyqtarja Roxana Comsa dhe Gjyqtari Ilmi Bajrami, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 shkurt 2011, lëshon këtë

#### AKTGJYKIM

1. Padia e ██████████-it me të cilën kërkohet njohja e të drejtës pronësore mbi ngastrën kadastrale ██████████ në vendin e quajtur "██████████" dhe anulimin e kontratës për shitblerje të tokës në mes të të ndjerit ██████████ "Fermë Kolektive Cer. Nr. 3203/1962 (më 15 dhjetor 1960) refuzohet si e pabazuar.
2. Vlera e çështjes gjyqësore vendoset nga Gjykata në vlerë prej 17,629 euro (shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë euro)
3. ██████████ obligohet të paguaj në Dhomën e Posaçme shumën prej 126.3 euro (njëqind e njëzet e gjashtë euro e tridhjetë cent) si taksë gjyqësore.

#### Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 26 shtator 2008, paditësi parashtrio padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme) për të vërtetuar atë si pronar të ngastrës kadastrale Nr. ██████████ me sipërfaqe prej 3, 52, 58 ha, e cila ndodhet në Çagllavisë. Paditësi kërkoi nga Dhoma e Posaçme që të anulojë kontratën e shitjes Nr. 3203/1962 e cila u nënshkrua më 15 dhjetor 1960, e vërtetuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 21 dhjetor 1962, në mes të babait të tij të ndjerë dhe paraardhëses ligjore të paditurës, Ferma Kolektive

“██████████”, si dhe t’i lejohej të njëjtit të regjistrohet në shënimet kadastrale. Ai kërkoi gjithashtu rimbursimin e shpenzimeve procedurale.

Me padinë e tij, ai e dorëzoi njoftimin për Agjencinë, kontratën e shitjes dhe autorizimin.

Paditësi tha se në vitin 1992 babai i tij i ndjerë ██████████, u detyrua t’ia shes ngastrën tokësore të përmendur më lartë paraardhëses së paditur. Paditësi pohoi se kontrata është në kundërshtim me nenin 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Për të vërtetuar pretendimet e tij, Paditësi ka propozuar të ftohen dëshmitarë.

Më 3 tetor 2008, në pajtim me nenin 25.4 të Urdhresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2006/17, Gjyqtari Raportues lëshoi një urdhër, me të cilin e udhëzoi paditësin që brenda dy jave nga pranimi i urdhrit, Dhomës së Posaçme t’ia paraqes informatat me shkrim në lidhje me këto çështje:

- Të dhënat kadastrale të parcelës Nr. ████████ në Çagllavicë,
- Dëshminë se ██████████ është trashëgimtare e Fermës Kolektive “██████████”,
- Hollësitë e dëshmimeve të cilat ai ka për qëllim t’i paraqes gjatë dëgjimit të lëndës për të vërtetuar pretendimet e tij, veçanërisht por të mos kufizohet në detyrimin e bërë,
- Dëshminë e trashëgimisë,
- Çfarë zgjidhje propozon ai për çmimin fillestar të paguar nga paraardhësja e të paditurës?

Paditësi i dorëzoi me kohë dokumentet e kërkuara dhe sqarimin më 28 tetor 2008. Ai shpjegoi se i ka kërkuar të dhënat kadastrale, por ende s’ka marrë përgjigje. Ai e dorëzoi aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Prishtinës P.br. 122/08 si dëshmi e faktit se KBI ██████████ është trashëgimtare e “██████████” dhe kërkoi emërimin e një eksperti financiar për të llogaritur çmimin fillestar.

Më 7 korrik 2009, Dhoma e Posaçme në mënyrë të përsëritur lëshoi urdhër për paditësin duke kërkuar nga ai informacionin me shkrim brenda një periudhe prej dy javësh nga data e pranimit të urdhrit në lidhje me këto çështje:

- Shënimet kadastrale për parcelën nr. ████████ në Çagllavicë. (nëse Paditësi nuk mundet ta sigurojë dokumentin siç ka pohuar më parë, ai duhet të dëshmojë se kërkesa e tij i është mohuar nga Zyra Kadastrale)
- Detajet e provave të cilat Paditësi ka ndërmend ti sjell gjatë seancës dëgjimore për t’i dëshmuar pohimet e tija, posaçërisht por duke mos u kufizuar në detyrim.
- Dëshminë e trashëgimisë, për të vërtetuar se paditësi është trashëgimtari i vetëm i të ndjerit ██████████ ██████████.

Me 28 korrik 2009, paditësi iu ka përgjigjur urdhrit dhe ka deklaruar se kadastra ka refuzuar që të lëshojë shënime kadastrale përveç organeve zyrtare apo gjykatave. Ai konsideron se certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi i të atit të tij e dëshmojnë trashëgiminë e tij, duke treguar se ende nuk ka mundur ta nxjerr certifikatën vdekjes për të atin e tij meqë dokumentet janë shkatërruar.

Me 17 dhjetor 2009, Dhoma e Posaçme ia ka dërguar padinë të paditurës. E paditura nuk ka paraqitur mbrojtje deri me sot edhe pse dorëzimi ishte bërë siç duhet.

Më 12 tetor 2010, Dhoma e Posaçme *ex officio* i ka kërkuar shënimet kadastrale për ngastrën e kontestuar.

Në të njëjtën ditë, padia iu ka dërguar Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)

AKP-ja ka paraqitur mbrojtje më 2 nëntor 2010. AKP-ja ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që ta refuzojë padinë si të pathemeltë. AKP-ja argumentoi se Paditësi nuk e ka paralajmëruar Agjencinë, nuk ka dhënë argumente ligjore për padinë, nuk ka paraqitur prova materiale, nuk e ka vërtetuar legjitimitetin aktiv (mungesa e vendimeve mbi trashëgiminë). Pastaj, AKP-ja deklaroi se koha për ta kërkuar anulimin e kontratës është parashkruar me që nëni 8. a i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 nuk zbatohet.

Me 26 nëntor 2010, Paditësi e ka paraqitur përgjigjen tij, me të cilën i ka përsëritur parashtresat e tij të mëhershme.

Në kundërpërgjigje të parashtruar më 6 janar 2011, AKP-ja pretendon se anulimi i kontratës është dashur të niset nga prokurori publik, përndryshe ajo ka mbetur pranë thënieve të saja të mëhershme.

Pas shumë përpjekjeve të pafrytshme, Gjykata më në fund më 31 janar 2011 i pranoi informatat nga Zyra Kadastrale Komunale e Graçanicës. Zyra Kadastrale e njoftoi Gjykatën se ngastra kadastrale ■■■ nuk ekziston në Çagllavicë.

Seanca dëgjimore publike e cila u caktua për 10 shkurt 2011, por që duhej të shtyhej për shkak të dërgimit të pasuksesshëm të AKP-së.

Në seancën vijuese më 24 shkurt 2011, palët i mbështetën deklaratat e tyre paraprake. Paditësi insistoi në atë se ngastra kadastrale ■■■ në Çagllavicë ekziston dhe si dëshmi ai dorëzoi dokumentet e lëshuara nga Republika e Serbisë, në fakt duke iu referuar ngastrës kadastrale ■■■ në Preoc. Ai gjithashtu i dorëzoi certifikatat e vdekjes dhe të lindjes të ■■■ dhe – për të vërtetuar legjitimitetin e argumenteve të tij i referohet nenit 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve – Aktvendimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës P.br 3182/97 ku – kinse – ngastra pronësore fqinjë nr ■■■.

E paditura e ka ngritur çështjen e zbatueshmërisë së Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke e marrë parasysh se ky ligj ka hyrë në fuqi më vonë nga koha kur është nënshkruar kontrata nga palët. AKP-ja më tej ngriti çështjen se nëse Paditësi dëshiron të përdorë nenin 8/a të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore, ai duhet të jetë i vetëdijshëm se procedurat e tilla të anulimit duhet të iniciohen nga prokurori publik. E Paditura, përfundimisht argumentoi se në lidhje me dallimin në mes të nullitetit dhe kontestueshmërisë siç parashihet nga Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve duke pohuar se kanosja mbi të cilën është bazuar padia nuk është rast i nullitetit, por është rast i kontestueshmërisë; prandaj është përshkruar tashmë.

### Arsyetimi Ligjor:

Pas vlerësimit individual dhe të kombinuar të fakteve dhe argumenteve të palëve, Dhoma e Posaçme konstaton se padia e ■■■ është e pabazuar.

1.) *Pasiguria në lidhje me ngastrën kadastrale 7/2*

Siç u përmend më lartë, Trupi i posedon dy dokumente të cilat kanë mospërputhje në lidhje me ekzistencën e ngastrës nr. ■■■. Ia vlen të theksohet se nga fillimi i çështjes gjyqësore në secilin dokument, ngastra e kontestuar tokësore ishte adresuar si nr. ■■■ me sipërfaqe prej 3, 52, 58 ha dhe e cila gjendet në Çagllavicë, gjë e cila nuk u kundërshtua asnjëherë nga paditësi, megjithëse ngastra e kontestuar me shumë gjasë nuk ndodhet në Çagllavicë. Trupi Gjyqësor, megjithatë, konstaton se nuk ka nevojë të rihapet procedura për të sqaruar nëse ngastra kadastrale në të vërtetë gjendet në Çagllavicë apo Preoc, pasi që nuk do të kishte ndikim në rezultatin përfundimtar të çështjes gjyqësore. Gjykata konstaton se është e kënaqshme mënyra se si ngastra e kontestuar është përshkruar. Për më tepër, vërtetimi i pronësisë është parakusht për anulimin e kontratës (Nr. 3203/1962 e miratuar më 15 dhjetor 1960, e vërtetuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 21 dhjetor 1962); nëse ky parakusht nuk është përmbushur, nuk ka nevojë të sqarohet më tutje lokacioni i saktë i ngastrës.

## 2.) *Zbatueshmëria e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve*

Paditësi e bazoi padinë e tij vetëm në Nenin 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 29/78). Në pajtim me Nenin 352.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006, tash e tutje LPK) në procedurën gjyqësore të tanishme të shkallës së parë ky ligj aktual duhet të zbatohet. Edhe pse Neni 253.1 i LPK-së e obligon Paditësen ta tregojë bazën ligjore të padisë, Neni 253.2 i të njëjtit ligj thekson se Gjykata nuk është e obliguar nga baza ligjore e padisë. Pavarësisht kësaj, Dhoma e Posaçme e sqaron këtë çështje kryesisht sepse në këtë lëndë në veçanti dhe në disa lëndë të tjera, paditësit janë duke cituar juridiksionin e gjykatave vendore nga vitet 1990ta ku prona ishte kthyer në bazë të Nenit 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Shumica e këtyre lëndëve dhe në veçanti lënda në fjalë e ka origjinën nga vitet 1960ta. Megjithatë, Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ka hyrë në fuqi më 1 tetor 1978. Neni 1106 i këtij ligji në mënyrë eksplicite thekson se dispozitat nuk do të zbatohen për obligimet e krijuara para kohës kur ligji hyri në fuqi e që është më 1 tetor 1978 (Neni 1109 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve). Përfundimisht, nuk ka mundësi ligjore për ta kthyer pronën dhe/ose për ta anuluar kontratën në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve kur një kontratë e tillë është para datës 1 tetor 1978.

Rrjedhimisht, padia është e pabazuar për shkak të kësaj arsye.

## 3.) *Shfuqizimi i kontratës*

Paneli nënvizon se edhe në rast se Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve do të ishte i zbatueshëm, padia gjithashtu nuk do të ishte e bazuar. Bazuar në arsyetimin e padisë, Neni 103 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nuk do të ishte i zbatueshëm. Neni 103 kërkon që kontrata të jetë bërë në kundërshtim me rregulloret detyruese, rendin publik ose praktikën e mira të biznesit. Megjithatë, kjo nuk është ajo se çfarë pohon Paditësi. Sipas padisë së tij, paraardhësi i tij ishte kërcënuar dhe e ka lidhur këtë kontratë nën ndikimin e këtij kërcënimi. Një situatë e tillë bie nën dispozitën e Nenit 60 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili thotë:

### *Kanosja*

(1) *Në qoftë se pala kontraktuese ose ndonjë i tretë me kanosje të palejueshme ka shkaktuar frikësim të bazuar te pala tjetër, kështu që kjo për këtë arsye e ka lidhur kontratën, ....*

(2) *Frika konsiderohet e bazuar në qoftë se nga rrethanat shihet se nga rreziku serioz është cenuar jeta, trupi ose ndonjë e mirë tjetër e rëndësishme e palës kontraktuese ose e personit të tretë.*

Dallimi në mes të këtyre dy dispozitave – Neni 103 në njërin anë dhe Neni 60 në anën tjetër – është i një rëndësie thelbësore, sepse pasojat ligjore e këtyre dy dispozitave janë tërësisht të ndryshme. Prandaj struktura, baza ligjore dhe terminologjia lidhur me shfuqizimin e një kontrate duhet të bëhet e qartë.

Së pari, shfuqizimi është termi i përgjithshëm që është një akt procedural; i përcakton paditë ku paditësit kërkojnë mundësinë që të dalin nga obligimi kontraktual duke pohuar se kontrata është e mangët. Qëllimi është që të arrihet që kontrata të deklarohet si e pavlefshme dhe në këtë mënyrë pa efekt juridik.

Në këtë kontekst “i pavlefshëm” është një term i përgjithshëm. Brenda asaj kategorie e drejta materiale, domethënë Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, dallon në mes në mes të dy koncepteve ligjore të ndryshme: *nulliteti* dhe *kontestueshmëria* (në përkthimin në gjuhën angleze të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të quajtur “kontrata relativisht të pavlefshme”). Dallimi dogmatik midis këtyre kategorive është se në rast të nullitetit, shteti (ligjvënësi) ndërhyrë drejtpërdrejtë në autonominë kontraktuale të palëve, ndërsa në rast të kontestueshmërisë kjo ndërhyrje është vetëm e kushtëzuar dhe e varur nga vullneti i një pale kontraktuese për ta kontestuar vlefshmërinë e kontratës.

Nulliteti është një kategori objektive, domethënë nuk varet nga liria e veprimit të palëve dhe/ose e gjykatës. Nulliteti është i pakushtëzuar – *ipso iure* – dhe shqyrtimi i rrethanave nuk është i nevojshëm (është indiferent me atë se çfarë ka qenë qëllimi i palëve kontraktuese). Gjykata e konsideron mundësinë e nullitetit *ex officio*; nuk ka asnjë afat të parashkrimit pasi që e drejta për ta pretenduar nullitetin nuk mund të përfundojë (Neni 109 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve). Në rast të nullitetit kontrata duket sikurse të mos kishte ekzistuar kurrë (*ex tunc*). Në mënyrë që të shmanget ngatërrimi lidhur me nullitetin e kontratës/obligimit, ligjvënësi e rregullon atë duke theksuar në mënyrë eksplicite se nëse kontrata është në kundërshtim me parimet përkatëse atëherë ajo është “nullë dhe e pavlefshme”. Rastet më të shpeshta të nullitetit janë si në vijim: i pamundur, i paligjshëm ose objekt i dëmtuar; paaftësia e palës kontraktuese (p.sh. i sëmurë mendorë, mund të pretendohet vetëm në interesin e një personi të tillë); kontratat e bëra me forcë fizike (shpallur vetëm nga Neni 8/a i Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike në vitin 1992).

Në anën tjetër, kontestueshmëria është një kategori subjektive, që nënkupton se pretendimet e palëve duhet të vërtetohen (rrethanat e kontratës). Kontestueshmëria është e kushtëzuar; vetëm atyre të cilëve u janë shkelur të drejtat drejtpërdrejt mund të pretendojnë atë brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj. Kur gjykata të shfuqizojë një kontratë në bazë kontestueshmërisë, e përfundon vetëm kontratën, që do të thotë se nuk ka ndikime të mëtejme (*ex nunc*), dhe palët duhet të kërkojnë në mënyrë eksplicite *in integrum restitutio*. Afati i parashkrimit është zakonisht një vit nga data e kontratës dhe/ose nga koha kur kotenstueshmëria ishte apo do të duhej realizuar në mënyrë të arsyeshme (neni 117 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve). Rastet më të zakonshme të kontestueshmërisë janë kanosja (neni 60) dhe gabimi i rëndë (neni 61).

Në lëndën në fjalë, Paditësi iu ka referuar parimit të nullitetit së kontratës. Ai pohoi se paraardhësi i tij ishte kërcënuar nga administrata dhe e Paditura; si pasojë, në bazë të mendimit të tij, kontrata duhet të jetë nullë dhe e pavlefshme. Nga sa u tha më lartë, megjithatë, është evidente se Paditësi gabimisht e ka përdorur argumentin e nullitetit. Gjatë tërë procedurës, ai asnjëherë nuk pohoi se paraardhësi i tij është kërcënuar fizikisht. Pretendimet e tij i referohen vetëm kanosjeve që

rezultojnë në zbatimin e nenit 60.1 më tepër se sa nenin 103. Prandaj, në bazë të theksimit të mësipërm, kontrata nuk është nullë dhe e pavlefshme. Të drejtat e Paditësit janë të kufizuara në kërkesën për anulim të kontratës, e cila mund të jetë relativisht e pavlefshme.

Megjithatë, kjo kërkesë nuk do të ishte e bazuar për dy arsye.

E para: përshkrimi i tij i fakteve në lidhje me kanosjen e pretenduar nuk është as konkret dhe as i specifikuar, dhe nuk ia lejon gjykatës një vlerësim nëse kjo kanosje ishte mjaft serioze për të plotësuar kërkesat e nenit 60 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

E dyta, edhe nëse përshkrimi i fakteve do të dukej si i mjaftueshëm, Paditësit nuk i lejohet ligjërisht të kërkojë anulimin e kontratës për shkak të skadimit të afatit kohor.

Siç u tha më lartë, kontestueshmëria është çështje e parashkrimit. Afati i përgjithshëm kohor i parashkrimit është 10 vjet në pajtim me nenin 379.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, që nënkupton se pas 10 vjetëve ç'do padi është e pabazuar për shkak të skadimit të afatit kohor. Afati kohor më specifik për kontestueshmëri përcaktohet në nenin 117 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, e drejta për të kërkuar anulimin e kontratës relativisht të pavlefshme do të mbaroj brenda një viti nga shfaqja e arsyes për anulimin relativ dhe në pajtim me paragrafin 2, në ç'do rast nga data e nënshkrimit të kontratës. Është evidente se të gjitha këto periudha kohore kanë skaduar para shumë kohe. Rrjedhimisht, Paditësi e ka humbur të drejtën për të kontestuar kontratën e shitblerjes së tokës Cer. Nr. 3203/1962 (të datës 15 dhjetor 1960) madje edhe nëse gjykata do ta merrte parasysh argumentin – i cili nuk u ngrit nga Paditësi – se gjatë regjimit shtypës të Jugosllavisë, qasja në gjykatë i është kufizuar, i apo i është mohuar.

#### 4.) *Kthimi dhe/apo kompensimi*

Duke e përfunduar atë që u tha më lartë, tani nuk ka ndonjë opsion për Gjykatën apo ndonjë autoritet tjetër në territorin e Kosovës që do të lejonte një vendim të kërkuar nga Paditësi. Pa e kontestuar vlefshmërinë e pretendimeve të Paditësit (dhe njerëzit në situata të ngjashme) duhet të theksohet se gjykatat dhe autoritetet tjera do të kërkonin bazën ligjore për të hyrë në këto argumente në nivel të përgjithshëm apo individual. Një ligj i tillë tashmë nuk ekziston. Në lidhje me atë, varet nga legjislatori për tu mbështetur në Propozimin Gjithëpërfshirës të Martti Ahtisarit për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës – në bazë të nenit 143 të Kushtetutës së Kosovës i zbatueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe madje mbizotërues ndaj vet Kushtetutës – që në mënyrë eksplicite përmend se kthimi i pronave duhet të adresohet. Derisa të miratohet ligji i përgjithshëm i cili i rregullon çështjet e kthimit të pronave, nuk ka bazë ligjore për të miratuar paditë si ajo e Paditësit.

#### Taksat gjyqësore:

Në përputhje me Nenin 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe Nenin 56.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 shpenzimet e procedurës gjyqësore do të barten nga pala e pasuksesshme, në këtë rast Paditësi.

Në pajtim me Nenin 10 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Udhëzimi Administrativ nr. 2008/02 lidhur me Rregullat Procedurale Shtesë për sa i përket taksave gjyqësore të caktuara nga Kryetari i Dhomës së Posaçme, taksat e Gjykatës janë sipas bazës vijuese:

- Për paditë të cilat nuk e kalojnë vlerën prej 10,000 euro (neni 10.1): taksa prej 50 euro me 0.5% deri në 500 euro;
- Për lëshimin e Aktgjykimit (neni 10.12): është njëjtë sikurse u përmend më lartë.

Pasi që Paditësi nuk e ka specifikuar vlerën e padisë së tij, është detyrë e Gjyqtarit të kalkulojë atë në pajtim me nenin 3.2 të Urdhëresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 2008/02. Si metodë të kalkulimit Dhoma e Posaçme e përdorë këtë: sipërfaqja e ngastrës kadastrale është shumëzuar me çmimin e vlerësuar të tregut prej 0.5 €/m<sup>2</sup> (35,258 m<sup>2</sup> \* 0.5€/m<sup>2</sup> = 17,629 €)

Prandaj, shuma e taksës gjyqësore është 176.3 €. Paditësi tashmë ka paguar shumën prej 50 €; kështu që Paditësi duhet të paguaj në Dhomën e Posaçme shumën shtesë prej 126.3 €.

E Paditura nuk pa paraqitur ndonjë kërkesë për rimbursim për shpenzimet e saj procedurale, dhe pasi që e Paditura përfaqësohet nga avokati i saj, e Paditura nuk e gëzon të drejtën e rimbursimit për pagesat e arsyeshme të avokatit.

#### Këshillë Ligjore

Në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankesa kundër këtij vendimi mund t'i ushtrohet Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi.

Norbert Koster, Gjyqtar Kryesues  
EULEX

nënshkruar

Roxana Comsa, Gjyqtare  
EULEX

nënshkruar

Sabri Halili, Gjyqtar

nënshkruar

Tobias Lapke, Regjistruer  
EULEX

nënshkruar

